



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, bazuar në Nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), Nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për ndryshim-plotësimin e paragrafit 1, pika 1.1, të vendimit Nr. 26, të datës 07.03.2016, për fillimin e procedurave për lejimin e ndërtimit të objekteve (afarist P+1 dhe depo P+0), në ngastrën kadastrale P-72514003-00779-6, në sipërfaqe të përgjithshme prej 5524m² në zonën kadastrale Harilaç, e evidentuar në certifikatën e pronës Nr. 05-095-30078, pronë në qirambajtje për 99 vite, nga pala Ruzhdi Thaqi me destinim për:
 - 1.1 Objekt për riciklimin e mbeturinave të plastikës me etazhitet P+0, në sipërfaqe S=351.88m²;
 - 1.2 Objekt afarist me etazhitet P+1, përdhese në sipërfaqe S=88.40m² dhe kati i parë në sipërfaqe S=93.51m².
2. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Inspektoratit, pas marrjes së dokumentacionit nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor.
3. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së Inspektoratit, Palës dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

43
07.04.2016



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 207, të datës 17.03.2016, paraqitur nga Drejtoria e Financave dhe Buxhetit, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (c), të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, shkronja (ç), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për aprovimin e buxhetit të shpenzuar në komunën e Fushë-Kosovës, për vitin 2015, në shumë të përgjithshme prej 8,268,162.02€.
2. Buxheti i shpenzuar nëpër njësitë buxhetore ekonomike është si vijon:
 - 2.1 Në administratë buxheti i shpenzuar është 3,703,851.01€;
 - 2.2 Në arsim buxheti i shpenzuar është 3,294,813.91€;
 - 2.3 Në shëndetësi buxheti i shpenzuar është 1,237,665.16€;
 - 2.4 Në Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim buxheti i shpenzuar është 31,831.94€.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Financave dhe Buxhetit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së FB dhe Arkivës.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Pravosudstvo



Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 183, të datës 21.03.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (a), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (a), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (c), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Strategjisë Komunale për Zhvillimin Ekonomik 2016-2020.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e Projekt-Strategjisë Komunale për Zhvillimin Ekonomik 2016-2020 dhe përfaqësuesit e drejtorive komunale, do të ofrojnë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar, grupet e interesit nga fusha e zhvillimit ekonomik lokal, arsimit, shëndetësisë e mirëqenies sociale, kulturës, rinisë e sportit, në debatet publike të caktuara për datën: 08.04.2016, 15.04.2016 dhe 22.04.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik dhe Drejtoritë tjera Komunale.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive Komunale dhe Arkivës.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 184, të datës 21.03.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (d), nenin 17, shkronja (s), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (I) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (n), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (ç), nenin 27, shkronja (nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Planit të Veprimit për Integrimin e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian në komunën e Fushë-Kosovës 2016-2018.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e Projekt-Planit të Veprimit për Integrimin e komuniteteve rom, ashkalinj dhe egjiptian në komunën e Fushë-Kosovës 2016-2018, përfaqësuesit e Drejtorive Komunale dhe Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim, do të ofrojnë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar dhe grupet e interesit nga fusha e ekonomisë, arsimit, shëndetësisë e mirëqenies sociale, kulturës, rinisë, sportit dhe administratës, në debatet publike të caktuara për datën: 21.04.2016 dhe 28.04.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës, Nënkrjetari i Komunës për Komunitete, Drejtoritë Komunale dhe Zyra Komunale e Komuniteteve dhe Kthim.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Nënkrjetarit për Komunitete, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Zëvendëskryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorive Komunale, ZKKK dhe Arkivës.

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës
Mr. Fadil Krasniqi





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Fushë-Kosovë



Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 185, të datës 21.03.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 7, nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e Projekt-Rregullores për ndarjen e titujve të nderit, çmimeve, mirënjohjeve dhe shpërblimeve tjera, përfaqësuesit e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, do të ofrojnë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar dhe grupet e interesit nga kultura dhe sporti, në debatet publike të caktuara për datën: 20.04.2016 dhe 27.04.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE



Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 186, të datës 21.03.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e Projekt-Rregullores për procedurat e themelimit dhe funksionimit të Këshillit të Veprimit Rinor në Komunën e Fushë-Kosovës, përfaqësuesit e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, do të ofrojnë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar dhe grupet e interesit, përfaqësuesit e rinisë, në debatin publik të caktuar për datën: 26.04.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

Pratini Kosova



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Data: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 187, të datës 21.03.2016, paraqitur nga Kryetari i Komunës së Fushë-Kosovës, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja (c), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Për dërgimin në procedurën e diskutimit publik të Projekt-Rregullores për punën vullnetare të të rinjve në Komunën e Fushë-Kosovës.
2. Komisioni i cili ka punuar në hartimin e Projekt-Rregullores për punën vullnetare të të rinjve në Komunën e Fushë-Kosovës, përfaqësuesit e Drejtorisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, do të ofrojnë informata të nevojshme për opinionin-qytetarët e interesuar dhe grupet e interesit, përfaqësuesit e rinisë, në debatin publik të caktuar për datën: 26.04.2016.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Drejtorisë së KRS dhe Arkivës.





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të dytë të Propozimit Nr. 05, të datës 22.01.2016, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, bazuar në nenin 11, nenin 12, paragrafi 12.1, shkronja (c), nenin 17, shkronja (d), nenin 40, paragrafi 40.2, shkronja (a, l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 22, nenin 23, të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 (Gazeta Zyrtare Nr. 18/2012), nenin 8, nenin 10, të Udhëzimit Administrativ për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifave për rregullimin e infrastrukturës Nr. 22/2012, nenin 12, paragrafi 12.1 shkronja (ç, nj), nenin 13, paragrafi 13.6, shkronja (c), nenin 27, shkronja (b, nj), të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, miratoi këtë

NDRYSHIM-PLOTËSIMIN E RREGULLORES PËR TARIFA NGARKESA DHE

GJOBA KOMUNALE

1. Miratohet ndryshim-plotësimi i 'Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 63', të datës 16.05.2013.
2. Me këtë ndryshim-plotësim të Rregullores shfuqizohet neni 14, i 'Rregullores për tarifa ngarkesa dhe gjoba komunale Nr. 63', e datës 16.05.2013 dhe vendimi Nr. 156, i datës 10.12.2014 dhe caktohet taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifa rregullative për ritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2016, për territorin e komunës së Fushë-Kosovës, Nr. 6444-2/15 01-DT:16.01.2016, për ndërtimet e kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë të objekteve si vijon:
 - 2.1 Taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore për vitin fiskal 2016 është në vlerë prej 2,40€ neto për m² dhe fitohet nga procesi i lëshimit të lejes-pranimit të aplikacionit për lëshimin e fletës poseduese, duke përfshirë zhvillimin dhe azhurnimin e Planit Rregullues Urban.
 - 2.2 Tarifa rregullative për ritjen e densitetit në infrastrukturë për vitin fiskal 2016, është e ndikuar nga ritja e popullsisë në komunën tonë dhe shërbimet komunale që ofrohen në: arsim, përkuqjesje shëndetësore, shërbime publike, mbrojtje e shpëtim, kulturë, rini e sport për kokë banori në komunën tonë, është fituar vlera prej 120.11€, e cila tarifë në zbërthim i bie të jetë 2,40€ për një m², të sipërfaqes neto.

3. Këto tarifa aplikohen për punët ndërtimore, që rrisin numrin e njësive banuese, shtëpi për vetëm një familje dhe ndërtesa për shumë familje-billoqet e apartamenteve.
4. Llogaritja dhe caktimi i taksës administrative për leje ndërtimore dhe tarifës rregullative për rrirjen e densitetit në infrastrukturë, nga pika dy (2) e këtij ndryshim-plotësimi të 'Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba', do të bëhet nga Drejtoria e Planifikimit Urban.
5. Për zbatimin e këtij ndryshim-plotësimi të 'Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale', është kompetente Drejtoria e Planifikimit Urban.
6. Ky ndryshim-plotësimi i 'Rregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoba Nr. 63', të datës 16.05.2013, hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e komunës dhe shfuqizon, nenin 14, të Rregullores Nr. 63 të datës 16.05.2013 dhe Vendimit Nr. 156, të datës 10.12.2014.

**Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së PU, Drejtorisë së INSPK dhe Arkivës.**





REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS / OPŠTINA KOSOVO-POLJE
MUNICIPALITY OF FUSHË-KOSOVË/KOSOVO-POLJE

Datë: 07.04.2016

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më datë 31.03.2016, pas shqyrtimit të Propozimit Nr. 44, të datës 21.03.2016, paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit Urban, në lidhje me kërkesën Nr. 05-350-7189, të datës 25.02.2016, të paraqitur nga palët: Ahmet Merovci, Ismet Merovci, Safet Merovci, Nexhmedin Merovci, Agron Merovci dhe investitori 'Cima', sh.p.k Bali Kabashi, të shqyrtuar në Komitetin për Politikë e Financa dhe Komitetin për Komunitete, bazuar në nenin 40, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, (Gazeta Zyrtare Nr. 28/2008), nenin 27, të Statutit të Komunës, Nr. 98, i datës 17.08.2012, mori:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi Nr. 44, i datës 21.03.2016, për ndërrimin e destinimit të ndërtimit dhe lejohet fillimi i procedurave për ndërtimin e objekteve shumëbanesore në ngastrën kadastrale Nr. 425/1 dhe 425-1, në sipërfaqe prej $S=9013m^2$, në zonën kadastrale Fushë-Kosovë, për rritje të etazhitetit nga B-P+1E+NK dhe B+P+3E, në B+P+7E+NK, për palët: Ahmet Merovci, Ismet Merovci, Safet Merovci, Nexhmedin Merovci, Agron Merovci dhe investitori 'Cima', sh.p.k Bali Kabashi.
2. Sipas Planit Zhvillimor Urban Fushë-Kosova 2004-2015, Planit Rregullativ Urban Fushë-Kosova 2004/2015, plotësimit të Planit Rregullativ Urban të Fushë-Kosovës, të vitit 2011, kjo zonë ka destinim për ndërtimin e objekteve individuale të banimit: B+P+1E+NK në sipërfaqe $S=116356.80m^2$ dhe B+P+3E në sipërfaqe $S=29865m^2$.
3. Hapësira e përgjithshme për ndërrim të destinimit për ndërtim, përfshin sipërfaqen totale prej $S=(116356.80+29865)m^2$, me hapësirat përcjellëse për rregullimin e infrastrukturës, shërbimeve sociale për qytetarët e zonës: çerdhe, shkollës, ambulancë, e tjera.
4. Kryerja dhe mbikëqyrja e procedurave për zbatimin e këtij vendimi, është në kompetencë të Kryetarit të Komunës, Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Drejtorisë së Inspektoratit.

5. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqen e komunës.

Akti i dorëzohet: Kryetarit të Komunës, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës,
Drejtorisë së PU, Drejtorisë së GJKP, Drejtorisë së INSPK, Palës dhe
Arkivës.

